



KONKURS I JASHTËM

Në bazë të skemës organizative në fuqi dhe nevojës për plotësimin e vendit të lirë të punës në Departamentin për Kontabilitet, Kontroll dhe Raportim, KEDS SH.A. më datë **04.08.2022** shpall vend të lirë pune:

Pozicioni i punës: Ekspert për llogari të arktueshme, llogari të pagueshme dhe taksa

Lokacioni: HQ, Prishtinë

PËRGJEGJËSITË KRYESORE:

- Siguron funksionalitetin e sistemit të Llogarive të arkëtueshme, të pagueshme, thesarit dhe monitoron transaksionet kontabël të vendosura në Librin Kryesor dhe kontrollon të dhënat e Kontabilitetit të distriktiteve për raportim të saktë të llogarive të pagueshme;
- Regjistron listëpagesat sipas raporteve të dorëzuara dhe bën barazimet mujore me librin kryesor;
- Ndihmon në përgatitjen e raporteve tatimore për qiratë në baza mujore si dhe të gjitha aktivitetet përkatëse;
- Përgatit regjistrin ditor të shpenzimeve cash me faturat përkatëse dhe regjistrin ditor të pagesave për faturat e furnitorëve dhe krijon raporte sipas kërkesave;
- Kontrollon procesin e përgjithshëm të pagesave të pagueshme dhe të arkëtueshme që reflektojnë në analizën e SNRF-ve dhe legjislacionit tatimor në Kosovë;
- Ndihmon në përgatitjen e librit të blerjeve dhe shitjeve të TVSH-së sipas legjislacionit tatimor të Kosovës;
- Bashkëpunon me Thesarin për të përcaktuar alokimet e pagesave të Llogarive të arkëtueshme dhe pagueshme dhe ndihmon sipas nevojës në përmbytjen e detyrave tjera profesionale;
- Shërben si pikë kontakti me Administratën Tatimore të Kosovës për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me Kontabilitet;
- Asiston dhe përgatit dokumentacionin e listës së kërkesave nga auditorët e brendshëm/të jashtëm dhe Administrata Tatimore e Kosovës në lidhje me Llogaritë e arkëtueshme, pagueshme dhe taksa;
- Kryen detyra shtesë sipas kërkesës së Menaxhmentit.

KËRKESAT DHE KUALIFIKIMET:

- Kualifikim Universitar, niveli Bachelor, Fakulteti Ekonomik;
- Eksperiencë pune 3 deri në 5 vite në Kontabilitet;
- Të jetë kontabilist/teknik i certifikuar apo në proces të certifikimit në: (SCAAK, ACCA)
- Njohuria e Gjuhës Angleze është e preferueshme;
- Të ketë njohuri të Standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit dhe legjislacionit në fuqi.

SI TË APLIKONI?

Ju mund të aplikoni përmes njërës nga mënyrat e mëposhtme:

1. Plotësoni aplikacionin tuaj online në linkun: <https://careers.keds-energy.com/#/>
2. Dërgoni aplikimin tuaj përmes adresës sonë të e-mailit: HR@keds-energy.com duke specifikuar në titull pozicionin për të cilin po aplikoni dhe duke bashkangjitur dokumentet e mëposhtme:
 - CV;
 - Diplomën e kualifikimit;
 - Dëshmi nga përvoja e punës/Trusti;
 - Certifikatat e trajnimeve të ndjekura;
 - Certifikata/Vërtetimi që nuk jeni nën hetime nga Gjykata;

Aplikimi është i hapur deri më datë: **15.08.2022**, në ora **16:00**.

SHËNIME ME RËNDËSI:

- KEDS ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë qytetarët pa dallim.
- Aplikimet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikimet e mangëta refuzohen.
- Vetëm kandidatët që plotësojnë kriteret dhe që për zgjedhen në listën e ngushtë do të kontaktohen.